



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

RAPORTI GJASHTË-MUJOR I PERFORMANCËS PËR KONSULTIMET PUBLIKE

QENDRA E QEVERISJES

Korrik 2021

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	3
2. FREKUENCA E KONSULTIMEVE PUBLIKE PËR PROJEKTLIGJET DHE PROJEKT STRATEGJITË	4
3. NUMRI I KONSULTIMEVE PUBLIKE PËR PROJEKTLIGJET ME VNR	6
4. PËRDORIMI I PËRJASHTIMEVE NGA KONSULTIMET PUBLIKE PËR AKTET NË PROGRAMIN ANALITIK, PLANIN KOMBËTAR PËR INTEGRIMIN EVROPIAN DHE DOKUMENTE STRATEGJIKE SEKTORIALE	7
5. KOHËZGJATJA E KONSULTIMEVE PUBLIKE PËR PROJEKTLIGJET, DOKUMENTET STRATEGJIKE DHE TË POLITIKAVE	9
6. PËRDORIMI I REGJISTRIT ELEKTRONIK PËRNJOFTIMIN DHE KONSULTIMIN PUBLIK PËR KONSULTIMET E PROJEKTLIGJEVE DHE PROJEKT STRATEGJIVE.....	12
7. ORGANIZIMI I TAKIMEVE PUBLIKE TË KONSULTIMIT PUBLIK PËR PROJEKTLIGJET DHE PROJEKT STRATEGJITË	14
8. SHKALLA E PËRFSHIRJES SË AKTORËVE TË JASHTËM, JO QEVERTARË NË HARTIMIN APO KONSULTIMET E PROJEKTLIGJEVE, PROJEKT STRATEGJIVE DHE DOKUMENTEVE TË POLITIKAVE SI ANËTARË GRUPEVE TË PUNËS / ORGANEVE KONSULTATIVE.....	16
9. NUMRI I PJESËMARRËSVE QË KONTRIBUOJNË NË KONSULTIMET PUBLIKE PËR PROJEKTLIGJET DHE PROJEKT STRATEGJITË ME KOMENTET DHE REKOMANDIMET E TYRE	18
11. SHKALLA E PRANIMIT TË KONTRIBUTEVE TË PALËVE TË INTERESIT NË PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK PËR PROJEKTLIGJET DHE PROJEKT STRATEGJITË	21
12. NDIKIMI I KONSULTIMEVE PUBLIKE NË RAPORTET E VNR-VE	24
13. CILËSIA E PERFORMANCËS INSTITUCIONALE NË ZBATIMIN E KONSULTIMEVE PUBLIKE	24
14. SHKALLA E REAZLIMIT TË PLANIT VJETOR TË KONSULTIMIT PUBLIK	28
15. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	28
SHTOJCË -PASAPORTA E TREGUESVE PËR MONITORIMIN E PROGRESIT NË ZBATIMIN E STANDARDEVE TË PROCESIT TË KONSULTIMIT PUBLIK PËR VITIN 2020	31

1. Hyrje

Përmirësimi i konsultimeve publike mbi projekt iniciativat ligjore dhe të politikave është konsideruar si një tregues i rëndësishëm i suksesit të reformës së administratës publike dhe funksionimit efektiv të qeverisjes demokratike dhe vendimmarrjes gjithëpërfshirëse e transparente. Angazhimi i publikut të interesuar në zhvillimin e politikave mundëson identifikimin në kohë të sfidave të mundshme për zbatimin e zgjidhjeve të politikave të përzgjedhur dhe kontribuon në rritjen e cilësisë së politikave.

Bazuar në Udhëzimin për Konsultimet Publike të miratuara me Urdhër të Sekretarit të Përgjithshëm të Kryeministrit, më 29 Janar 2021, ky raport gjysmë-vjetor përdor metodologjinë e re të raportimit të rezultateve të konsultimeve publike, e cila bazohet në një seri treguesish të performancës që kontribuojnë në një monitorim të plotë të progresit të ministrive të linjës në zbatimin e standardeve të miratuara për konsultimin publik. Në përputhje me kuadrin metodologjik të parashikuar, janë zhvilluar dy faza të hartimit të gjysmë-vjetor.

Në fazën e parë, ministratë përgatitën dhe konsoliduan raportet gjysmë-vjetore me të gjitha të dhënat analitike të kërkuara, me mbështetjen e Departamentit të Zhvillimit në Kryeministriti dhe Departamentit Rregullator dhe të Përputhshmërisë duke bashkërenduar mbledhjen dhe verifikimin e të dhënave për konsultimet publike të kryera nga ministratë e linjës.

Në fazën e II-të, filloi procesi i përgatitjes së raportit vjetor të performancës së qeverisë qendrore, duke marrë parasysh të gjitha të dhënat analitike të mbledhura nga raportet e ministrive të linjës.

Në pararendje të procesit të hartimit të raporteve gjysmë-vjetore të ministrive të linjës, u organizuan 12 ëbinares të dedikuara për secilën ministri dhe u trajnuan 86 punonjës, i) Koordinatorë të Konsultimit Publik, ii) Përfaqësues nga Drejtoria e Politikave, iii) Përfaqësues nga Drejtoria Ligjore, me qëllim sigurimin e kuptimit të harmonizuar të elementëve kryesorë të raportit gjysmë-vjetor dhe përforcimin e njohurive mbi Udhëzuesin e Konsultimit Publik.

Ministrive, gjatë përgatitjes së raporteve të tyre, u është siguruar vazhdimisht mbështetje nga Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes në bashkëpunim me Departamentin Rregullator dhe të Përputhshmërisë, duke dërguar komentet dhe vlerësime për draft raportet sektoriale të përgatitura me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe janë asistuar nga Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit lidhur me procesin e publikimit të raporteve në Rregjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik.

Përveç kësaj, me qëllim sigurimin e vlefshmërisë të raportit gjysmë-vjetor të performancës së qeverisë qendrore mbi konsultimet publike, është organizuar një ëbinares me aktorët kryesorë të dy Departamenteve të Kryeministrit, Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Për secilin nga treguesit e performancës të vlerësuar në këtë raport janë dhënë shpjegime metodologjike, pasuar nga përmbledhja e gjetjeve kryesore për periudhën janar-qershor 2021. Vlerësimi fillon me një përmbledhje të performancës institucionale të ministrive për sa i përket sasisë (frekuencës) së konsultimeve publike - gjithashtu në lidhje me përdorimin e përjashtimeve për aktet në Programin Analitik, PKI dhe dokumentet strategjike sektoriale. Kjo vijohet nga vlerësimi i cilësisë së procesit të konsultimeve bazuar në rezultatin e parashikuar nga Udhëzimi. Më pas, vlerësohen një seri treguesish në lidhje me kohëzgjatjen e konsultimeve publike, përdorimin e Regjistrit Elektronik për Njoftim dhe Konsultim Publik, organizimin e takimeve publike, si mjet të konsultimit publik, shkalla e përfshirjes së aktorëve të jashtëm joqeveritarë në hartimin ose konsultimet mbi projektligjet, dokumentet strategjike dhe të politikave, si anëtarë të grupeve të punës/organeve konsultative, numri i pjesëmarrësve që kontribuojnë në konsultimet publike, raportimi mbi rezultatet e konsultimeve, por edhe shkallën e pranimet të kontributeve të palëve të interesit në procesin e konsultimit publik. Së fundmi, janë adresuar konsistenca dhe kuptimësia e konsultimeve publike tek raportet e VNR-së.

Në përgjithësi, raporti gjysmë-vjetor tregon progres në lidhje me respektimin e standardeve të konsultimit publik si në terma sasiorashtu edhe cilësore. Paraqitet rritje e indeksit të përdorimit të Regjistrit Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik, rritje të Indeksit të frekuencës së organizimit të takimeve publike si mjet i konsultimit publik mbi projektligjet dhe strategjitë, rritje të indeksit pranimet (ndikimit) të kontributeve të palëve të interesuara në procesin e konsultimit publik për projektligjet dhe strategjitë. Gjithashtu raporti evidenton progres lidhur me uljen e indekseve të përdorimit të kriterëve të përjashtimit/ përjashtimeve nga konsultimet publike për akte në Programin Analitik dhe Planin Kombëtar për Integrim Evropian.

Paraqitet qendrueshmëri lidhur me realizimin e frekuencës së konsultimeve publike për aktet objekt i ligjit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik dhe cilësisë së procesit, megjithatë trendi në këtë periudhë është në rënie krahasur me vitin 2020.

Sidoqoftë, ka ende një numër sfidash për t'u adresuar. Së pari, angazhimi i ministrive dhe forcimi i kompetencave dhe përgjegjësi të Koordinatorit të Konsultimit Publik lidhur me procesin.

2. Frekuenca e konsultimeve publike për projektligjet dhe projekt strategjitë

Përkundër një viti mjaft sfidues të shënuar nga kriza pandemike e COVID-19, frekuenca e konsultimeve publike mbi projektligjet dhe projekt strategjitë rezulton qendrueshmekrahasuar me vitin 2020.

Formula e mëposhtme e llogaritjes përdoret për Indeksin e Frekuencës së Konsultimit Publik (IFPC) për projektligjet dhe projekt strategjitë:

Numri i projektligjeve, projekt strategjive dhe dokumenteve të politikave të miratuara përmes

$$IFPC = \frac{\text{procesit të konsultimit publik gjatë një viti}}{\text{Numri total i projekt ligjeve, dokumenteve strategjike dhe të politikave të miratuara nga qeveria që duhet të paraqiteshin për konsultim publik}} \times 100$$

Në llogaritjen e numrit të përgjithshëm të projektligjeve dhe projekt dokumenteve të strategjive dhe politikave të miratuara nga qeveria që duhet të paraqiteshin për konsultim publik, duhet të merren parasysh dispozitat e Nenit 1 të Ligjit Nr. 146/2014 për Njoftimin dhe Konsultimin Publik –ku parashikohet se aktet që i nënshtrohen konsultimit publik janë: 1) projektligjet dhe 2) projektvendimet që miratojnë dokumente strategjike dhe politika me interes të lartë publik.

Përveç kësaj, duhet të merren parasysh përjashtimet nga konsultimi publik të parashikuara nga neni 4 i Ligjit për Konsultimin Publik - përkatësisht:


- Çështjet e sigurisë kombëtare, për sa kohë që ato përbëjnë sekret shtetëror, në përputhje me ligjin për informacionin e klasifikuar "Sekret shtetëror";
- Marrëveshjet ndërkombëtare, marrëveshjet bilaterale dhe multilaterale
- Aktet individuale administrative dhe aktet normative administrative, përveçse kur parashikohet ndryshe nga njëligji i posaçëm;
- Aktet normative, me fuqinë e ligjit të miratuar nga Këshilli i Ministrave;
- Emergjencat civile.

Pasi aplikohen përjashtimet e nevojshme, numri i përgjithshëm i akteve për të cilat kërkohet kryerja e konsultimeve publike arrin në **18, ndërsa konsultimet publike janë kryer për 13 akte.**

Kjo e bën **Indeksin e përgjithshëm të Frekuencës së Konsultimeve Publike për gjashtë-mujorin e parë 2021 të rezultojë: 72,22%.**

Rezultati i Indeksit për vitin 2021 paraqet qendrueshmëri krahasuar me vitin e plotë 2020 (79,57%) ku hendeku kundrejt gjithë ciklit të plotë është vetëm -7.35 pikë përqindje.

Grafiku 1: Progresi i Frekuencës së Konsultimeve Publike 2018-2021 (gjashtë-mujori i parë)




3. Numri i konsultimeve publike për projektligjet me VNR

Raportet e VNR-së zakonisht nuk marrin shumë vëmendje nga publiku i gjerë gjatë konsultimeve publike pasi rëndësia e diskutimit mbi efektet e mundshme të opsioneve të zgjedhura të politikave nuk është kuptuar ende nga palët të ndryshme të interesit si një komponent i rëndësishëm i procesit të zhvillimit të politikave. Kjo pjesë merret me treguesin që mat numrin e konsultimeve publike të zhvilluara për projektligje me VNR dhe përqindjen e projektligjeve me VNR që janë miratuar përmes konsultimeve publike në raport me numrin e përgjithshëm të projektligjeve me VNR. Gjatë gjashtë-mujorit të parë 2021, nga 13 akte të konsultuara, 4 ishin projektligje dhe 9 projektvendime të Këshillit të Ministrave. Nga 4 projektligje me VNR, 3 prej tyre iu nënshtruan procesit të konsultimit publik ose 75%. Asnjë raport VNR nuk është ndryshuar pas procesit të konsultimit publik.

Ka një lloj tendence/trendi jo me rritje të indikatorit duke e krahasuar me vitin cikël të plotë 2020 ku nga 46 projektligje të konsultuara, **38** projektligje u pasuan nga raportet e VNR-së ose **82,61%** e të gjitha projektligjeve.

Grafiku 2: Numri i konsultimeve publike për projektligjet me VNR 6MI2021




4. Përdorimi i përjashtimeve nga konsultimet publike për aktet në Programin Analitik, Planin Kombëtar për Integrimin Evropian dhe dokumente strategjike sektoriale

Përjashtimet nga konsultimet publike për aktet në Programin Analitik

Ky tregues mat frekuencën e përdorimit të përjashtimeve nga konsultimet publike (kriteret e përjashtimit të përmendura në nenin 4 të Ligjit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik) për aktet e parashikuara në planin vjetor legjislativ të Qeverisë (Programi Analitik). Ai matet si përqindje e akteve të parashikuara në Programin Analitik për të cilat janë përdorur përjashtime nga konsultimet publike, sipas përcaktimeve të nenit 4 të këtij Ligji.

Programi Analitik Vjetor i akteve për tu miratuar gjatë vitit 2021 përmban 303 akte (*Vendimi nr. 1121 datë 30.12.2020*). Numri i përgjithshëm i akteve të konsultuara të parashikuara në Programin Analitik është **12** që do të thotë se numri i akteve të parashikuara në Programin Analitik për të cilat janë përdorur përjashtime nga konsultimi publik (kriteret e përjashtimit të nenit 4) është **291**. Prandaj, nëse vlerësojmë të gjitha aktet nga Programi Analitik, Indeksi i Përdorimit të Përjashtimeve nga Konsultimi Publik për akte në programin e përgjithshëm Analitik është **96%**. **Krahasuar me ciklin e plotë vjetor 2020 (88,68%) paraqitet një rritje (jo pozitive) e kriterëve përjashtues me +7.32 pikë përqindje.**

Grafiku 3: Përjashtimet nga konsultimi publik për aktet në Programin Analitik Vjetor



Përqindja e akteve të konsultuara të planifikuara në Programin Analitik (12) në raport me numrin e përgjithshëm të akteve të konsultuara (13) është **92,3%, indikator që paraqet një trend pozitiv rritës krahasuar me vitin 2020 (66.21%)**.

Brenda listës së 18 akteve të miratuara që duhet të kryejnë konsultime publike, 14 janë planifikuar në Programin Analitik Vjetor dhe nga këto 12 akte të planifikuara kanë kaluar përmes konsultimeve publike. Me specifikisht theksohet se kur vlerësohen vetëm aktet e miratuara nga Programi Analitik, indeksi i përdorimit të përjashtimeve nga konsultimi publik është 14,28%.

Për vitin 2020 për aktet e miratuara nga Programi Analitik, nuk ka pasur përjashtime nga konsultimi publik.

Përdorimi i përjashtimeve nga konsultimi publik për aktet në Planin Kombëtar të Integritimit Evropian

Ky tregues mat frekuencën e përdorimit të përjashtimeve nga konsultimi publik (kriteret e përjashtimit të përmendura në nenin 4 të Ligjit për Njoftimi dhe Konsultimin Publik) për aktet e parashikuara në Planin Kombëtar për Integritimin Evropian (PKIE). Ai matet si përqindje e akteve të parashikuara në PKIE për të cilat janë përdorur përjashtime nga konsultimi publik (kriteret e përjashtimit sipas nenit 4).

Nga 13 akte të miratuara që janë konsultuar gjatë gjashtë-mujorit të parë të vitit 2021, ministritë kanë raportuar 4 akte të konsultuara që janë planifikuar në PKIE, këto akte rezultojnë që janë planifikuar edhe në Programin Analitik, ashtu si dhe në PKIE. Rezulton që 10 akte nga PPAP nuk janë planifikuar në PKIE.

Nga këto 4 akte të planifikuara në PKIE , **4 janë konsultuar** dhe 0 janë përjashtuar nga konsultimi publik. **Përsa më sipër realizueshmëria e PKIE-së lidhur me aktet e konsultuara për këtë periudhë rezulton 100% ose 0% të përjashtuara.**

Pozitive rezulton edhe e dhëna mbi aktet e paplanifikuara por që janë konsultuar. Me specifikisht 4 akte **(22,22%)** nuk ishin planifikuar as në Programin Analitik dhe as në PKIE. **Rezultati krahasuar me vitin 2020 ka një tendencë në përmirësim, nga ku 36 akte (38.71%) është reduktuar në 4 akte (22.22%).**

Përdorimi i përjashtimeve nga konsultimi publik për aktet në dokumentet strategjike sektoriale

Ky tregues mat frekuencën e përdorimit të përjashtimeve nga konsultimi publik (kriteret e përjashtimit të përcaktuara në nenin 4 të Ligjit për Njoftimin dhe Konsultimin publik) për aktet e parashikuara në dokumentet strategjike sektoriale. Ai matet si përqindje e akteve të parashikuara në dokumentet strategjike sektoriale për të cilat janë përdorur përjashtime nga konsultimi publik (kriteret e përjashtimit sipas nenit 4).

Gjatë vitit 2021 (6M i I) rezulton që ministrinë kanë planifikuar miratimin e 108 projektakteve të cilat lidhen me dokumenta strategjikë, përgjatë gjashtë-mujorit të parë 2021, ministrinë kanë miratuar 15 akte që lidhen me dokumente të ndryshme strategjike sektoriale.

Nga 18 akte të miratuara në vitin 2021 (6M i I) , që duhej t'i nënshtroheshin konsultimeve publike, 7 akte ishin planifikuar në dokumente të ndryshme strategjike sektoriale. Nga 13 akte të miratuara që janë konsultuar gjatë vitit 2020, ministrinë kanë raportuar se 6 akte të konsultuara janë planifikuar në dokumente të ndryshme strategjike të sektorit.

Pra, 8 akte të parashikuara në dokumentet strategjike sektoriale janë përjashtuar nga konsultimet publike **(53%), i cili paraqet një të dhënë të ngjashme krahasuar me vitin 2020 (53.48%) ose 23 akte të përjashtuara.**

Nga 7 akte të miratuara që duhen konsultuar gjatë gjashtë-mujorit të parë 2021, ministrinë kanë raportuar se të 6 **akte** që janë planifikuar në dokumente të ndryshme strategjike të sektorit janë konsultuar. **Realizueshmëria e konsultimit të akteve të miratuara të parashikuara në dokumentat strategjik rezulton 85,71 % përkundrejt 100% të akteve në vitin 2020, ose 20 akte të miratuara.**

5. Kohëzgjatja e konsultimeve publike për projektligjet, dokumentet strategjike dhe të politikave

Ky tregues paraqet të dhënat në lidhje me kohëzgjatjen minimale të konsultimeve publike për projektligjet dhe projekt strategjitë, të parashikuara në Ligjin për Njoftimin dhe Konsultimin Publik. Ai mat përqindjen e projektligjeve, projekt dokumenteve strategjike dhe të politikave të konsultuara për të cilat konsultimi publik ka zgjatur të paktën 20 ditë pune. Formula e

mëposhtme përdoret për llogaritjen e Indeksit të Respektimit të Kohëzgjatjes së Konsultimit Publik (IPCDC) për projektligjet, projekt dokumentet strategjike dhe të politikave.

$$\text{IPCDC} = \frac{\text{Numri i projektligjeve dhe projektstrategjive të konsultuar në një vit për të cilat konsultimi publik ka zgjatur të paktën 20 ditë pune}}{\text{Numri total i projektligjeve dhe projekt strategjive të konsultuara}} \times 100$$


Nga 13akte të konsultuara gjithsej, për 5akte konsultimet publike kanë zgjatur të paktën 20 ditë pune. Prandaj, Indeksi i Respektimit të Kohëzgjatjes së Konsultimit Publik (IPCDC) për projektligjet projekt strategjitë dhe dokumentet e politikave është **38,46%**. Prandaj (IPCDC= $5/13 * 100 = 38,46\%$) **e akteve janë në pajtueshmëri me kërkesat ligjore për të paktën 20 ditë pune. Indikatori është pozitiv pasi tregon që 100% e akteve të konsultuara kanë përmbushur afatin minimum ligjor për konsultim.**

Krahasuar me vitin ciklik 2020, indikatori paraqet një tendencë pozitive në ulje të indeksit nga 74,32% në 38,46%.

Tabela1: Pasqyra e akteve në përputhje me kërkesën ligjore të kohëzgjatjes së konsultimeve publike (të paktën 20 ditë pune.)

Ministra	Akte të pa konsultuara	Numri i akteve të konsultuara për të paktën 20 ditë pune	Numri i akteve të konsultuara më shumë se 20 ditë pune	Indeksi IRKKP (% e akteve të konsultuara për të paktën 20 ditë pune)
M Evropës dhe Punëve të Jashtme	0	1	0	100
M Bujqesise dhe Zhvillimit Rural	0	1	1	50
M Mjedisit dhe Turizmit	0	0	1	100
M Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	0	0	2	0
M Brendshme	0	0	4	0
M Financave dhe Ekonomisë	4	1	0	100

Grafiku 4: Indeksi IRKKP në nivel krahasueshmërie



Një nga sfidat e rëndësishme në përmirësimin e cilësisë së konsultimeve publike lidhet me parashikueshmërinë e kohëzgjatjes dhe kryerjes së procesit të konsultimit publik. Sipas të dhënave të siguruara nga ministritë e linjës nënjë rast, Ministria e Mjedisit, akti është konsultuar për periudhën 25.06.2020 - 25.03.2021, rreth 187 ditë përpara miratimit në Këshill të Ministrave.


Kohëzgjatja mesatare e konsultimeve publike për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale është 151 ditë dhe për Ministrinë e Brendshme 88 ditë. Kohëzgjatja mesatare e të gjitha konsultimeve publike është 80 ditë (pune). **Tendencë pozitive për respektuar afatin minimum ligjor dhe zvogëluar kohëzgjatjen e konsultimit publik krahasuar me vitin 2020 ku mestarja ishte 113 ditë pune.**

Tabela 2: Kohëzgjatja mesatare e konsultimeve publike të ministrive të linjës

Ministritë	Kohëzgjatja mesatare e konsultimeve publike (në ditë pune)
M Evropës dhe Punëve të Jashtme	20
M Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	20

M Mjedisit dhe Turizmit	187
M Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	151
M Brendshme	88
M Financave dhe Ekonomisë	20

Grafiku 5: Kohëzgjatja mesatare e konsultimeve publike



6. Përdorimi i regjistrit Elektronik për Njoftimin dhe Konsultimin Publik për konsultimet e projektligjeve dhe projekt strategjive

Ky tregues paraqet të dhëna lidhur me përdorimin e Regjistrit Elektronik për Njoftim dhe Konsultim Publik për kryerjen e konsultimeve publike mbi projektligjet dhe projekt strategjitë. Treguesi paraqet përqindjen e projektligjeve të konsultuara, projektdokumenteve strategjike dhe të politikave për të cilat janë kryer konsultimet publike përmes Regjistrit Elektronik për Njoftimin dhe Konsultimin Publik (RENJKP).

Formula e mëposhtme përdoret për llogaritjen e Indeksit të përdorimit të Regjistrit Elektronik për Njoftimin dhe Konsultimin Publik (IERNPC) për kryerjen e konsultimeve publike mbi projektligjet dhe projekt strategjitë.

Raporti i projektligjeve dhe projekt strategjive të konsultuara për të cilat u kryen konsultimet publike përmes RENJKP:

$$\text{IERNPC} = \frac{\text{Numri i projektligjeve dhe projekt strategjive të konsultuara përmes RENJKP}}{\text{}} \times 100$$

Numri total i projektligjeve dhe projekt strategjive të konsultuara (gjatë një vitit)

Gjatë gjashtë-mujorit të parë të vitit 2021, **13 nga 14**akte të konsultuara janë publikuar në regjistrin Elektronik për konsultime publike ose**92,85** %e të gjitha akteve të konsultuara. Ky tregues ka një rritje krahasuar me vitin ciklik të plotë 2020,**90,54** % ose 67 akte të konsultuara.

Grafiku 6: Raporti i akteve të konsultuara dhe publikuar ne RENJK në nivel krahasueshmërie





Tabela3: Pasqyrë e numrit të akteve të konsultuara të cilat janë publikuar në RENJKP

Ministria	Numri i akteve të konsultuara	Numri i akteve të konsultuara përmes RENJKP	% e përdorimit të RENJKP
Ministria e Brendshme	5	5	100%
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	2	1	50%
Ministria e Drejtësisë	1	1	100%
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	2	2	100%
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	1	1	100%
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	1	1	100%
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	2	2	100%
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	0	0	0
Totali	14	13	92.85%

Grafiku 7: Përdorimi i Regjistrit Elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike



Të dhënat e përmendura tregojnë një nivel mjaft të lartë të përputhshmërisë me detyrimin ligjor të publikimit të projekt-akteve në Regjistrin Elektronik. Pritet që përditësimi i deklaruar i Regjistrit Elektronik të kontribuojë në përdorimin e tij më të madh nga publiku i gjerë.


7. Organizimi i takimeve publike të konsultimit publik për projektligjet dhe projekt strategjitë

Formula e mëposhtme përdoret për llogaritjen e **Indeksit të Frekuencës së Organizimit të Takimeve Publike (IPM)** si mjet për konsultimin e projektligjeve, projekt dokumenteve strategjike dhe të politikave - përqindja e projektligjeve dhe projekt strategjive të konsultuara për të cilat janë organizuar takime publike gjatë periudhës së hapur për konsultime:

$$IPM = \frac{\text{Numri i projektligjeve dhe projekt strategjive të konsultuara në një vit për të cilat janë organizuar takime të konsultimit publik}}{\text{Numri total i projektligjeve dhe projekt strategjive të konsultuara (gjatë një viti)}} \times 100$$


Gjatë gjashtë-mujorit të parë 2021, nga gjithsej 13 akte të konsultuara, për 11 akte janë organizuar takime publike që çon në Indeksin e Frekuencës së Organizimit të Takimeve Publike (IPM) në **84,61%** ($IPM = 11/13 * 100 = 84,61\%$). Ky indikator paraqet një tendencë pozitive, progresive krahasuar me vitin e plotë 2020 (63.01%) me 21.6 pikë përqindje.

Grafiku 8: Frekuenca e organizimit të takimeve publike si mjete të konsultimeve publike




Përveç Regjistrimit Elektronik të qeverisë qendrore dhe takimeve publike, përdoren gjithashtu posta elektronike, komitetet konsultative dhe metoda të tjera të tilla si ëëb-faqet e ministrave të linjës. Më poshtë është përmbledhja e përdorimit të metodave të ndryshme të konsultimeve publike me numrin e akteve për të cilat janë përdorur metoda të ndryshme të konsultimeve:

Grafiku 9: Përdorimi i metodave të ndryshme të konsultimeve publike përgjatë 6M I, 2021



Grafiku 10: Përdorimi i metodave të konsultimit publik në nivel krahasueshmërie 2020 vs 6M,2021



Kjo përmbledhje e numrit të akteve që janë mbështetur në përdorimin e metodave të ndryshme të konsultimeve publike tregon se ekziston ende një hapësirë për përmirësimin e diversifikimit të përdorimit të metodave të ndryshme që mund të kontribuojnë në shtrirjen e një spektri më të gjerë të palëve të interesuara të interesuara.

8. Shkalla e përfshirjes së aktorëve të jashtëm, jo qeveritarë në hartimin apo konsultimet e projektligjeve, projekt strategjive dhe dokumenteve të politikave si anëtarë grupeve të punës / organeve konsultative

Përfshirja sa më e madhe e aktorëve të jashtëm, joqeveritarë në hartimin ose konsultimet mbi projektligjet, dokumentet strategjike dhe të politikave si anëtarë të grupeve të menaxhimit të integruar të politikave/organeve konsultative tregon hapjen dhe gjithëpërfshirjen e fazës së hershme të formulimit të politikave që shpesh ofron potencialin më të madh për ndikim të palëve të interesuara për përmbajtjen e drafteve të politikave dhe nismave ligjore.

Qëllimi pas këtij treguesi është të ndjekë trendet në numrin e aktorëve të jashtëm, jo-qeveritarë si anëtarë të emëruar të grupeve të menaxhimit të integruar të politikave/organeve konsultative për hartimin e akteve të reja përmes një formule:


IËG= Numri i aktorëve joqeveritarë të përfshirë në hartimin dhe/ose konsultimet mbi projektligjet dhe strategjitë si anëtarë të emëruar të grupeve të menaxhimit të integruar/organeve konsultative.

Gjatë gjashtë-mujorit të parë 2021, ministritë e linjës raportuan **276** aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë të përfshirë në hartimin dhe/ose konsultimet mbi projektligjet dhe projekt strategjitë si anëtarë të emëruar të grupeve të menaxhimit të integruar të politikave/organeve konsultative (GP) ose organeve konsultative.

Tabela 4: Numri i palëve të interesit në grupet e menaxhimit të integruar/organet konsultative në ministritë e linjës

Ministria	Numri i palëve të interesit në Grupet e menaxhimit të Integruar të Politikave	% në numrin total të palëve të interesit në Grupet e menaxhimit të Integruar të Politikave
Ministria e Brendshme	50	18%
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	13	5%
Ministria e Drejtësisë	6	2%
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	186	67%
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	11	4%
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	1	0%
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	9	3%
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	0	0%
Totali	276	100%

Grafiku 11: Raporti i palëve të interesit të përfshirë në mekanizmin GMIP



Më së shumti, numri më i madh i aktorëve të jashtëm është raportuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e cila raportoi 150 palë të interesuara (si anëtarë të grupeve të punës të organeve konsultative) të përfshirë në hartimin dhe/ose konsultimet mbi Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030.

Nga ana tjetër, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nuk raportuan asnjë konsultim me palë të interesuar joqeveritare të përfshirë në dhe / ose konsultime mbi projekt iniciativat ligjore dhe politike si anëtarë të grupeve të punës ose organeve konsultative.


Në vitin 2020 numri i pjesëmarrësve ishte 1565, ku 1129 pjesëmarrës ishin vetëm për 2 akte, të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë - përkatësisht Projekt Plani Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Infrastrukturës Digjitale Broadband 2020-2025, i cili tërhoqi 744 pjesëmarrës, dhe Projektligji për ndryshimet e Ligjit për Eficiencën e Energjisë me 385 pjesëmarrës.

9. Numri i pjesëmarrësve që kontribuojnë në konsultimet publike për projektligjet dhe projekt strategjitëme komentet dhe rekomandimet e tyre

Ky tregues(*IPARTICIP*) mat numrin e pjesëmarrësve (aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë) që kanë kontribuar në konsultimet publike për projektligjet dhe projekt strategjitë me komentet dhe rekomandimet e tyre - përmes çfarëdo metode - Regjistri Elektronik, takimet publike, e - postat, këshillat konsultativ, etj. Ky është një tregues i rëndësishëm i cilësisë së komunikimit dhe shtrirjes së procesit të konsultimit publik.

Gjatë gjashtë-mujorit të parë 2021, ministritë raportuan **144 pjesëmarrëskontribues** në konsultime publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit. Duke marrë në konsideratë që në kushtet e pandemisë zhvillimi i takimeve konsultative është realizuar kryesisht nëpërmjet platformave të mbledhjeve online Zoom dhe Eebex, jo të gjitha ministritë adaptuan formate të tilla si mundësi konsultimi por shmangën zhvillimin e organizimeve konsultative nisur nga ky arsyetim. Ministria me numrin më të madh të pjesëmarrësve kontribues është Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Grafiku 11 Numri i pjesëmarrësve në konsultimet publike 2019-2021 (6M I 2021)




Megjithatë, **144 pjesëmarrës kanë kontribuar** në konsultimet publike me komentet e tyre (që përbëjnë 52.1% të të gjithë pjesëmarrësve). Më poshtë paraqitet një pasqyrë e numrit të kontribuesve në konsultimet publike për ministritë e linjës/ agjencitë:

Tabela 5:Numri i pjesëmarrësve që dhanë kontribut në konsultimet publike

Ministria	Numri i pjesëmarrësve kontribues	% në numrin total të kontribuesve
M Drejtësisë	2	1%
M Financave	11	8%
M Bujqësisë	2	1%
M Mjedisit	8	6%
M Shëndetësisë	80	56%
M Bujqësisë	1	1%
M Brendshme	40	28%
	144	100%

Grafiku 12: Numri i pjesëmarrësve që kontribuan në konsultimet publike në vitin 2021 (6M i I 2021)



Periudha e gjashtë-mujorit të parë 2021 (52.1%) krahasuar me vitin 2020 (14.4%) si cikël i plotë paraqitet si një nga indikatorët më me performancë dhe trend pozitiv me një rritje 37.7 pikë përqindje duke treguar se tashmë procesi po karakterizohet dhe orientohet drejt përmbajtjes dhe rezultateve.


10. Raportimi mbi rezultatet e konsultimeve –reagueshmëria institucionale ndaj komenteve/rekomandimeve të marra për konsultimet publike të projektligjeve dhe projekt strategjive

Ky tregues mat shkallën e reagueshmërisë institucionalendaj komenteve dhe rekomandimeve të marra për konsultimet publike mbi projektligjet dhe projekt strategjitë. Treguesi matet përmes përqindjes së projektligjeve dhe projekt strategjive të konsultuara për të cilat janë publikuar raportet mbi rezultatet e konsultimeve publike në raport me numrin e përgjithshëm të projektligjeve dhe projekt strategjive të konsultuara - në përputhje me formulën më poshtë:

$$I_{RESPONSE} = \frac{\text{Numri i projektligjeve dhe projekt strategjive të konsultuara për të cilat janë publikuar raporte të rezultateve të konsultimeve publike}}{\text{Numri total i projektligjeve dhe projekt strategjive të konsultuara}} \times 100$$

Gjatë gjashtë-mujorit të parë 2021, nga 13 akte të konsultuara, për 11 akte të ministrive të linjës janë përgatitur dhe publikuar raporte për rezultatet e konsultimeve publike - që është **84,61 %** e të gjitha akteve. Ky indeks është i përmirësuar në raport me performancën e vitit 2020, **82,43%**, dhe e ngjashme me performancën e vitit 2019, 84%.

Grafiku 13 – Shkalla e reagueshmërisë institucionale vs numri i raporteve të konsultimit të publikuara



Në lidhje me publikimin e raporteve mbi rezultatet e konsultimeve publike Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Mjedisit dhe Turizmit kanë demonstruar performancën më të ulët, pasi nuk kanë publikuar raportet për të gjitha aktet e konsultuara.

11. Shkalla e pranimit të kontributeve të palëve të interesit në procesin e konsultimit publik për projektligjet dhe projekt strategjitë

Ky tregues mat ndikimin e pjesëmarrjes së publikut në kuadër të pranimit të kontributeve të palëve të interesit në konsultimet publike mbi projektligjet dhe projekt strategjitë (përmes çdo metode - Regjistri Elektronik, takimet publike, posta elektronike, këshillat konsultative, etj.). Treguesi matet përmes përqindjes së numrit të përgjithshëm të komenteve/rekomandimeve të marra nga palët e interesuara që janë pranuar nga ministritë/organet qeveritare. Për qëllim të matjes më integrale të këtij treguesi, merren parasysh komentet/rekomandimet plotësisht dhe pjesërisht të pranuar.

Ky tregues llogaritet duke përdorur formulën e mëposhtme:

Numri i komenteve të pranuar plotësisht + numri i komenteve të pranuar pjesërisht për projektligjet dhe


$$\text{IACCEPT} = \frac{\text{projekt strategjitë}}{\text{Numri total i komenteve të marra}} \times 100$$

Gjatë gjashtë-mujorit të parë 2021, numri i përgjithshëm i komenteve të marra përmes të gjitha metodave të konsultimeve publike për projekt iniciativat ligjore dhe të politikave ishte **150**. Numri më i madh i komenteve është marrë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030 (60), Për miratimin e Planit Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuar 2021-2025 (40), Ministria e Drejtësisë për P-Ligjin për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar (23).

Nga ana tjetër, 27,77% e të gjitha projekteve të iniciativave ligjore dhe të politikave të miratuara gjatë gjashtë-mujorit të parë 2021, **nuk janë konsultuar me asnjë nga palët e interesit cila ka një progres ulje (tendencë pozitive) krahasuar me vitin 2020 me 22.3 p.p**. Ky informacion tregon nevojën për një komunikim më proaktiv të të gjitha konsultimeve publike nga ministrat e linjës dhe sqarimin më të mirë të ndikimit të mundshëm të konsultimeve publike mbi palët e interesuara të prekura.


Nga 150 komente të marra, 96 komente janë pranuar, 28 pjesërisht të pranuar dhe 26 të refuzuara.

Grafiku 14: Shkalla e pranueshmërisë së komenteve gjatë konsultimit publik në nivel krahasueshmërie




Krahasuar me vitin ciklik të plotë 2020 gjashtë-mujori i parë i vitit 2021 paraqet një trend shumë pozitiv me një rritje 13 p.p lidhur me bashkë-bërjen e kuadrit të politikave dhe atij legjislativ, nga ku 64% e komenteve janë konsideruar të plota vs 2020 (51%). Nëse konsiderojmë dhe trendin e komenteve të pranuar pjesërisht shkalla e pranueshmërisë kalon mbi mesataren 83% vs 60 (v.2020)

Grafiku 15 – Pasqyrë e shkallës së pranimi të komenteve të palëve të interesit në vitin 2021 (6MI 2021)



Numri i përgjithshëm i komenteve të pranuar plotësisht dhe të pranuar pjesërisht për projektligjet dhe projekt strategjitë e konsultuara në vitin 2021 (6m i I) është **124**. Kur pjesëtohen me numrine përgjithshëm të komenteve të marra, shkalla e pranimi të kontributeve të palëve të interesit në konsultimet publike për projektligjet dhe projekt strategjitë në vitin në vitin 2021 (6m i I) është **82,66%**, duke treguar një rritje të konsiderushme krahasuar me 2020 (59,79%) dhe 2019 (65,84%).

Grafiku 16– Pasqyrë e shkallës së pranimi të komenteve të palëve të interesit në vitin 2021 (6M i I) kundrejt vitit 2020



12. Ndikimi i konsultimeve publike në raportet e VNR-ve

Gjatë vitit gjatë vitit 2021 (6M i I) numri i projektvendimeve që i janë nënshtruar procesit të konsultimit publik është më i lartë se numri i projektligjeve, një e dhënë që rezulton për herë të parë në procesin e konsultimit publik. Numri total i projektvendimeve objekt i konsultimit të miratuara është 14, nga të cilat të konsultuara 10. Prej të cilave dokumenta politikash dhe plane kombëtare 6.

Gjatë vitit 2021 (6M i I), nga 4 projektligje të konsultuara, të gjitha këto projektligje u shoqëruan nga raportet e VNR-së. Ky seksion merret me një tregues specifik i cili mat ndikimin e konsultimeve publike në raportet e VNR-së- përkatësisht numrin e raporteve të VNR-së që u ndryshuan ose përditësuan bazuar në informacionin/të dhënat e marra gjatë procesit të konsultimit publik.

Bazuar në të dhënat e mbledhura nga ministritë e linjës, nga 3 projektligje të konsultuara me raportet e VNR-së, asnjë raport RIA (0%) nuk është ndryshuar si rezultat i kontributeve të marra gjatë konsultimeve publike.

Projektligjet e konsultuara me raport VNR janë aktet e Ministrisë së Drejtësisë, P-Ligj për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar, Ministria e Financave, P-Ligj për një ndryshim në ligjin nr.48/2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare” dhe Ministria e Bujqësisë P-Ligj për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”.

Ndërsa P-Ligj për një ndryshim në ligjin 10081/2009, për licencat, autorizimet dhe lejet në RSh të ndryshuar i Ministrisë së Financave nuk është konsultuar.

13. Cilësia e performancës institucionale në zbatimin e konsultimeve publike

Indeksi i Cilësisë së Performancës Institucionale në zbatimin e konsultimeve publike vlerëson nivelin e informacionit të siguruar nga ministritë për përmbushjen e kërkesave (kriterëve) të përcaktuara në Ligjin Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, përkatësisht:

- Informacion mbi publikimin e informacionit në sistemet qeveritare të informacionit (Regjistri elektronik dhe programi i transparencës)
- Konsultimet publike të mbajtura për të paktën 20 ditë pune
- Grupet e palëve të interesit të përfshira në procesin e konsultimit
- Raporti mbi numrin e përgjithshëm të rekomandimeve të nxjerra grupet e interesit dhe palët e interesuara të publikuara në regjistrin elektronik
- Informacion mbi komentet e pranuar / reflektuara kundrejt komenteve të paraqitura të disponueshme në Raport.

Metodologjia ndjek qasjen për matjen e cilësisë së konsultimeve publike të hartuar me mbështetjen e SIGMA me qëllim monitorimin e progresit në përmbushjen e treguesve të përcaktuar në mbështetjen buxhetore për reformën e administratës publike dhe bazohet në të dhënat e raporteve për konsultimet publike të ministrive të mbledhura nga Kryeministria, si dhe të dhënat e mbledhura përmes RENJKP dhe ëeb-faqeve të internetit të ministrive.

Ky tregues llogaritet duke përdorur tabelën e rezultateve më poshtë bazuar në vlerësimin vijues me dy pikë të cilësisë së performancës institucionale: (IIP)

-një pikë nëse ekzistojnë prova mbi përmbushjen e kërkesave të ligjit dhe

-një pikë nëse informacioni është gjithëpërfshirës në nivelin e pritur.

Tabela 6— Rezultatet— Cilësia e performancës institucionale në respektimin e standardeve të konsultimit publik

0	1	2	3	4
<i>Asnjë nga elementet nuk është përmendur</i>	<i>1-3 Pikë</i>	<i>4-5 Pikë</i>	<i>6-7 Pikë</i>	<i>8 Pikë</i>
Nuk është ofruar informacion për konsultimin publik	Projektligjet janë botuar në sistemin e informacionit qeveritar, por asnjë përfshirje e palëve të interesuara nuk ka	Projektligjet janë botuar në sistemin e informacionit qeveritar për të paktën 20 ditë pune, asnjë raport mbi përfshirjen e palëve të interesit nuk është	Projektligjet janë botuar në sistemin e informacionit qeveritar, raporti për përfshirjen e palëve të interesuara është nxjerrë dhe ruhen prova të mjaftueshme mbi	Projektligjet publikohen në sistemin e informacionit qeveritar, sigurohet informacion i mjaftueshëm për konsultime të gjera me palët e interesit; ruhen prova të

	ndodhur	nxjerrëdhe nuk mbahen prova të mjaftueshme mbi reagimet e tyre.	reagimet e tyre, por nuk ka informacion nëse reagimet janë reflektuar në draftin e ri	mjaftueshme mbi reagimet e tyre, një shkallë e mirë e reflektimit të reagimeve të palëve të interesuara pasqyrohet në draftin e ri
--	---------	---	---	--


Ky indeks është llogaritur në përputhje me një tabelë pikësh, ku 13akte kanë marrë pikët e mëposhtme siç përshkruhet në tabelën më poshtë:

Tabela7: Pikët e cilësisë së konsultimeve publike në vitin 2020

Numri i akteve	Pikët	Totali
10akte	8 pikë	80
3akte	3pikë	9
5akte	0pikë	0
Total (13 akte)		89
Indeksi i cilësisë së performancës institucionale në respektimin e kërkesave të Ligjit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik (527/93)		4,94

Me rezultatin e përgjithshëm prej 4,99 në vitin 2021 (6M i I) ka pasur një rënie në cilësinë e performancës institucionale krahasuar me ciklin e plotë të viteve të mëparshme (5,66 në 2020, 5,12 në 2019), gjithësesi ka një trend progresiv krahasuar me periudhat gjashtë-mujore respektive. Pasqyra e rezultateve për performancën individuale të të gjitha akteve të ministrive të linjës në lidhje me cilësinë e konsultimeve publike në vitin 2021 (6M i I) është në dispozicion në Shtojcën 1.

Grafiku 17 – Progresi në cilësinë e performancës institucionale në zbatimin e konsultimeve publike




14. Shkalla e reazlimit të Planit Vjetor të Konsultimit Publik

Me miratimin e Udhëzuesit të Konsultimit Publik, u përmbush dhe angazhimi institucional për hartimin e Planeve Vjetore të Konsultimit Publik Sektoriale 2021 dhe Planit të Përgjithshëm Vjetor të Konsultimit Publik 2021, bazuar mbi procesin e vlerësimit të akteve për konsultim publik sipas përcaktimeve në ligjin 146/2014, ‘Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik’.

Ministritë për vitin 2021 kane planifikuar konsultimin e 86 projektakteve dhe projektvendimeve nga të cilat për periudhën janar-qershor 2021 kane miratuar 14 prej tyre.

12 akte nga 13 që i janë nënshtruar konsultimit publik (92,3%), janë parashikuar në Planin Vjetor të Konsultimit Publik.

Grafiku 18 – Konsultimi i akteve të parashikuara në Planin Vjetor të Konsultimit Publik 2021



15. Konkluzione dhe rekomandime

Konkluzione

1. Rezulton rënie e lehtë në sasinë (frekuencën) e konsultimeve publike në vitin 2021. Indeksi i Frekuencës së Konsultimeve publike është 72,22% krahasuar me 79,57% në vitin 2020 ose -7,35 pikë përqindje.
2. Me rënie prej 0.72 pikë rezulton gjithashtu dhe cilësia e konsultimeve publike, (bazuar në tabelën e pikëve të miratuar me mbështetjen e SIGMA/EC) me rezultatin e përgjithshëm prej 4,94 për gjashtë-mujorin e parë 2021 krahasuar me 5,66 në vitin 2020, dhe 5,12 në 2019.
3. Nga 13 akte të konsultuara, 5 akte konsultimi publik ka zgjatur të paktën 20 ditë pune (38,46%) në përputhje me Ligjin për Konsultimet Publike. Kohëzgjatja mesatare e raportuar e konsultimeve publike është 79 ditë pune.
4. 13 nga 14 akte të konsultuara janë publikuar në Regjistrin Elektronik për Konsultimet Publike ose 92,85% e të gjitha akteve të konsultuara, gjë që tregon një nivel mjaft të lartë të respektimit të detyrimit ligjor të publikimit të akteve në Regjistrin Elektronik.
5. Nga 14 akte të konsultuara gjithsej, për 11 akte janë organizuar takime publike që e çon Indeksin e Frekuencës së organizimit të Takimeve Publike (IPM) të jetë 78,57% krahasuar me 63,01%.
6. Gjatë vitit 2021 (6M i I), të gjitha ministritë raportuan 267 pjesëmarrës në konsultime publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit. Kjo është në një rënie krahasuar me vitin 2020, megjithatë numri i pjesëmarrësve që kontribuan në konsultimet publike me

komentet e tyre, që është 54% krahasuar me 14,4% e të gjithë pjesëmarrësve në vitin 2020. Kjo tregon një interes në rritje të palëve të interesit për të marrë pjesë aktive në konsultimet e hapura mbi projekt iniciativat ligjore dhe të politikave.

7. Numri i përgjithshëm i komenteve të pranura plotësisht dhe të pranura pjesërisht për projektligjet dhe projektstrategjitë e konsultuara në vitin 2021 (6M i I) është 124. Kur pjesëtohet me numrin e përgjithshëm i komenteve të mbledhura (150), shkalla e pranimi të kontributeve të palëve të interesit në konsultimet publike mbi projektligjet dhe strategjitë në vitin 2021 (6M i I) është **82,66%**, krahasuar me 59,79% në vitin 2020.

12	Metodologjia	Ky tregues mat numrin e pjesëmarrësve (aktorëve të jashtëm, jo-qeveritarë) që kontribuojnë në konsultimet publike për projektligjet dhe strategjitë me komentet dhe rekomandimet e tyre, përmes çdo metode, Regjistrin Elektronik, takimeve publike, postës elektronike, këshillat konsultativ, etj.. Ai mat numrin e kontribuesve për të hapur konsultimet publike, si një tregues i rëndësishëm i cilësisë së komunikimit dhe shtrirjes së procesit të konsultimit publik me palët e jashtme, jo-qeveritare. Metodologjia bazohet në mbledhjen e të dhënave sasiore nga ZKM bazuar në raportimin administrativ të ministrive të linjës në konsultimet e kryera publike, si dhe bazuar në të dhënat e mbledhura përmes Regjistrin Elektronik dhe faqeve të internetit të ministrive. es.
13	Frekuenca e matjes	Vjetore dhe gjysmëvjetore
14		Vjetore
15	Treguesi / Natyra e treguesit: Kumulative/Në rritje	I Papërcaktuar
16	Treguesit agregat	/

17	Formula e llogaritjes (Jepet formula për mënyrën e llogaritjes së vlerës së këtyre treguesve)	Ky tregues llogaritet si: IPJES= numri i pjesëmarrësve (aktorë të jashtëm, jo-qeveritar) që kanë kontribuar në konsultimet publike për projektligjet dhe startegjitë me komentet dhe rekomandimet e tyre (në një vit) Gjatë vitit 2021 (6M i I), të gjitha ministratë raportuan 144 pjesëmarrës në konsultime publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit.
18	Ndarja e të dhënave (Treguesit agregat)	/
19		/
20		/
22	Baza fillestare	2019
23		581
24	Vlera / Synimet	2020
25		1565
		2021 (gjashtë-mujori i parë)
		144
26		2022 / Trendi në rritje
27	Vlera e rishikuar/ Synimet	
28	Vlera / Synimet	/
29	Referenca e Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshem (QZHQ)	16.7 Siguroni vendimmarrje të përgjegjshme, gjithëpërfshirëse, pjesëmarrëse dhe përfaqësuese në të gjitha nivelet 16.6 Zhvillimi i institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe transparente në të gjitha nivelet
30	Fushat e lidhura me standardet e tjera	/

		TREGUESI 11
1	Treguesi	Indeksi i përgjigjes institucionale ndaj komenteve/ rekomandimeve të marra për konsultimet publike mbi projektligjet dhe strategjitë
2	Lloji i treguesit	Produkti
3	Referenca e lidhur me dokumentet/ strategjitë strategjike	Strategjia e Reformës së Administratës Publike 2015-2020
4	Referenca e lidhur me SKZHI	Lidhur me shtyllën: Mirëqeverisja & Demokracia dhe Sundimi i Ligjit
5	Referencë e lidhur me qëllimin e politikës së Dokumentit të Strategjisë	Objektivi 2 i Strategjisë së Reformës së Administratës Publike 2015-2020
6	Qëllimi i politikës	Politikëbërja dhe cilësia e legjislacionit
7	Objektivi specifik	Sistemi transparent dhe gjithëpërfshirës i hartimit të ligjeve, i cili bazohet në politikat dhe, i cili siguron përafrimin me acquis
8	Treguesi / masa	Sasior

9	Burimi i shërbimit për monitorimin e treguesve të performancës	Raporti vjetor i qeverisë qendrore për konsultimet publike, raportet vjetore të ministrive të linjës, Regjistri Elektronik i Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike, faqet e internetit të ministrive të linjës
10	Institucionet përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave	ZKM-Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes
11		
12	Metodologjia	Ky tregues mat shkallën e reagimit institucional ndaj komenteve dhe rekomandimeve të marra për konsultimet publike mbi projektligjet dhe strategjitë. Treguesit maten përmes përqindjes së projektligjeve dhe strategjive të konsultuara për të cilat janë botuar raporte mbi rezultatet e konsultimeve publike, brenda numrit të përgjithshëm të projektligjeve dhe strategjive të konsultuara. Metodologjia bazohet në mbledhjen e të dhënave sasiore nga ZKM bazuar në raportimin administrativ të ministrive të linjës në konsultimet e kryera publike, si dhe bazuar në të dhënat e mbledhura përmes Regjistrit Elektronik dhe faqeve të internetit të ministrive. s.
13	Frekuenca e matjes	Vjetore dhe gjysmëvjetore
14		Vjetore
15	Treguesi / Natyra e treguesit: Kumulative/Në rritje	Në rritje
16	Treguesit agregat	/

17	Formula e llogaritjes (Jepet formula për mënyrën e llogaritjes së vlerës së këtyre treguesve)	Ky tregues llogaritet: Numri i projektligjeve dhe strategjive të konsultuara për të cilat janë publikuar raportet mbi rezultatet e konsultimeve publike IPËRGJIGJE= _____ x 100 Numri i përgjithshëm i projektligjeve dhe strategjive të konsultuara Gjatë vitit 2021(6M i I), nga 13 akte të konsultuara, për 11 akte të ministrive të linjës janë përgatitur dhe publikuar raporte për rezultatet e konsultimeve publike - që është 84,61% e të gjitha akteve.
18	Ndarja e të dhënave (Treguesit agregat)	/
19		/
20		/
22	Baza fillestare	2019
23		84%
24	Vlera / Synimet	2020
25		82.43%
		2021 (gjashtë-mujori i parë)
		84,61%
26		2022 / Trendi në rritje
27	Vlera e rishikuar/ Synimet	
28	Vlera / Synimet	/
29	Referenca e Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshem (QZHQ)	16.7 Siguroni vendimmarrje të përgjegjshme, gjithëpërfshirëse, pjesëmarrëse dhe përfaqësuese në të gjitha nivelet 16.6 Zhvillimi i institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe transparente në të gjitha nivelet
30	Fushat e lidhura me standardet e tjera	/

		TREGUESI 12
1	Treguesi	Shkalla e pranimi (ndikimit) të kontributeve të palëve të interesuara në procesin e konsultimit publik për projektligjet dhe strategjitës
2	Lloji i treguesit	Produkti
3	Referenca e lidhur me dokumentet/ strategjitë strategjike	Strategjia e Reformës së Administratës Publike 2015-2020
4	Referenca e lidhur me SKZHI	Lidhur me shtyllën: Mirëqeverisja & Demokracia dhe Sundimi i Ligjit
5	Referencë e lidhur me qëllimin e politikës së Dokumentit të Strategjisë	Objektivi 2 i Strategjisë së Reformës së Administratës Publike 2015-2020
6	Qëllimi i politikës	Politikëbërja dhe cilësia e legjislacionit
7	Objektivi specifik	Sistemi transparent dhe gjithëpërfshirës i hartimit të ligjeve, i cili bazohet në politikat dhe, i cili siguron përafrimin me acquis

8	Treguesi / masa	Sasior
9	Burimi i shërbimit për monitorimin e treguesve të performancës	Raporti vjetor i qeverisë qendrore për konsultimet publike, raportet vjetore të ministrive të linjës, Regjistri Elektronik i Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike, faqet e internetit të ministrive të linjës
10	Institucionet përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave	ZKM-Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes
11		
12	Metodologjia	Ky tregues mat ndikimin e pjesëmarrjes së publikut në drejtim të pranimit të kontributeve të palëve të interesuara në konsultimet publike mbi projektligjet dhe strategjitë (përmes çdo metode - Regjistrit Elektronik, takimeve publike, postës elektronike, këshillave konsultativ, etj.). Treguesit maten përmes përqindjes së numrit të përgjithshëm të komenteve/rekomandimeve të marra nga palët e interesuara që janë pranuar nga ministritë/organet qeveritare. Për qëllime të matjes më integrale të këtij treguesi, do të merren parasysh komentet/rekomandimet e pranuar plotësisht dhe pjesërisht. Metodologjia bazohet në mbledhjen e të dhënave sasiore nga ZKM bazuar në raportet e ministrive për konsultimet e kryera publike, si dhe të dhënat e mbledhura përmes RENJKP dhe faqeve të internetit të ministrive.
13	Frekuenca e matjes	Vjetore dhe gjysmëvjetore
14		Vjetore
15	Treguesi / Natyra e treguesit: Kumulative/Në rritje	Në rritje

16	Treguesit agregat	Ky tregues përfshin komentet e pranuar plotësisht dhe pjesërisht
17	Formula e llogaritjes (Jepet formula për mënyrën e llogaritjes së vlerës së këtyre treguesve)	Ky tregues llogaritet duke përdorur formulën e mëposhtme: Numri i komenteve të pranuar plotësisht + numri i komenteve pjesërisht të pranuar për projektligjet dhe strategjitë $IPRANUAR = \frac{\text{Numri i komenteve të pranuar plotësisht + numri i komenteve pjesërisht të pranuar}}{100} \times 100$ Numri i përgjithshëm i komenteve të marra Numri i përgjithshëm i komenteve të pranuar plotësisht dhe të pranuar pjesërisht për projektligjet dhe projekt strategjitë e konsultuara në vitin 2020 është 124. Kur pjesëtohen me numrin e përgjithshëm të komenteve të marra, shkalla e pranimi të kontributeve të palëve të interesit në konsultimet publike për projektligjet dhe projekt strategjitë në vitin 2021 (6M i I) është 82,66% $124/150 \times 100 = 82,66\%$
18	Ndarja e të dhënave (Treguesit agregat)	Shtresa 1 - Numri i komenteve të pranuar plotësisht
19		Shtresa 2 - Numri i komenteve të pranuar pjesërisht
20		/
22	Baza fillestare	2019
23		65.84%
24	Vlera / Synimet	2020
25		59.79%
		2021 (gjashtë-mujori i parë)
		82,66%
26		2022 / Trendi në rritje
27	Vlera e rishikuar/ Synimet	
28	Vlera / Synimet	/

29	Referenca e Qëllimeve të ZHvillimit të Qëndrueshem (QZHQ)	16.7 Siguroni vendimmarrje të përgjegjshme, gjithëpërfshirëse, pjesëmarrëse dhe përfaqësuese në të gjitha nivelet 16.6 Zhvillimi i institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe transparente në të gjitha nivelet
30	Fushat e lidhura me standardet e tjera	

		TREGUESI 13
1	Treguesi	Numri i raporteve të VNR-së që u ndryshuan / azhurnuan bazuar në informacionin/të dhënat e marra gjatë konsultimit publik
2	Lloji i treguesit	Produkti
3	Referenca e lidhur me dokumentet/strategjitë strategjike	Strategjia e Reformës së Administratës Publike 2015-2020
4	Referenca e lidhur me SKZHI	Lidhur me shtyllën: Mirëqeverisja & Demokracia dhe Sundimi i Ligjit
5	Referencë e lidhur me qëllimin e politikës së Dokumentit të Strategjisë	Objektivi 2 i Strategjisë së Reformës së Administratës Publike 2015-2020
6	Qëllimi i politikës	Politikëbërja dhe cilësia e legjislacionit
7	Objektivi specifik	Sistemi transparent dhe gjithëpërfshirës i hartimit të ligjeve, i cili bazohet në politikat dhe, i cili siguron përafrimin me acquis

8	Treguesi / masa	Sasior
9	Burimi i shërbimit për monitorimin e treguesve të performancës	Raporti vjetor i qeverisë qendrore për konsultimet publike, raportet vjetore të ministrive të linjës, Regjistri Elektronik i Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike, faqet e internetit të ministrive të linjës
10	Institucionet përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave	ZKM-Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes
11		
12	Metodologjia	Ky tregues vlerëson gatishmërinë e ministrive për të ndryshuar ose azhurnuar raportet e VNR-së bazuar në informacionin e marrë përmes konsultimeve publike. Treguesi llogaritet si përqindje e projektligjeve për të cilat raportet VNR-së janë ndryshuar ose azhurnuar bazuar në informacionin/të dhënat e marra përmes konsultimit publik (IVNR) Metodologjia bazohet në mbledhjen e të dhënave sasiore nga ZKM bazuar në raportet e ministrive për konsultimet e kryera publike, si dhe të dhënat e mbledhura përmes RENJKP dhe faqeve të internetit të ministrive.
13	Frekuenca e matjes	Vjetore dhe gjysmëvjetore
14		Vjetore
15	Treguesi / Natyra e treguesit: Kumulative/Në rritje	Në rritje
16	Treguesit agregat	/

17	Formula e llogaritjes (<i>Jepet formula për mënyrën e llogaritjes së vlerës së këtyre treguesve</i>)	Ky tregues llogaritet duke përdorur formulën e mëposhtme: Numri i projektligjeve për të cilat raportet e VNR-së janë ndryshuar ose azhurnuar bazuar në informacionin/të dhënat e marra përmes konsultimit publik IVNR = _____ x 100 Numri i përgjithshëm i projektligjeve të konsultuar me VNR nga 3 projektligje të konsultuara me raportet e VNR-së, asnjë raport RIA (0%) është ndryshuar si rezultat i kontributeve të marra gjatë konsultimeve publike. 3/0*100=0%
18	Ndarja e të dhënave (Treguesit agregat)	/
19		/
20		/
22	Baza fillestare	2020
23		26.31%
		2021
		0%
24	Vlera / Synimet	2020 / Trendi në rritje
25		2021/Trendi në rritje
26		2022 / Trendi në rritje
27	Vlera e rishikuar/ Synimet	
28	Vlera / Synimet	/
29	Referenca e Qëllimeve të ZHVillimit të Qëndrueshem (QZHQ)	16.7 Siguroni vendimmarrje të përgjegjshme, gjithëpërfshirëse, pjesëmarrëse dhe përfaqësuese në të gjitha nivelet 16.6 Zhvillimi i institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe transparente në të gjitha nivelet
30	Fushat e lidhura me standardet e tjera	/

	Indikatori No.14 (Indeksi per gjithe procesin)
Emertimi i Indikatorit	.Indeksi i cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e Ligjit për Njoftim dhe Konsultimet Publike
Lloji i indikatorit	Tregues rezultati
Emertimi i Dokumentit	Strategjia Ndersektorale e Administrates Publike
Lidhja me SKZHI (Nr i Shtylles)	Shtylla No.2. QEVERISJA E MIRË, DEMOKRACIA DHE SHTETI I SË DREJTËS
Qëllimi/Objektivi Strategjik ne SKZHI	Qellimi Strategjik SKZHI: Reformimi i administratës publike dhe shërbimit civile
Qëllimi i politikës korresponduese	Qellimi I Politikës:Politikëbërja dhe cilësia e legjislacionit
Objektivi Specifik me te cilin lidhet indikatorit/treguesi	Objektivi Specifik 2: Sistem transparent i hartimit të ligjeve, gjithëpërfshirës, i bazuar në politika dhe që siguron përafrimin me acquis
Perkatesia e Indikatorit	Kuader politikash
Lidhja me Acquis Communautaire	Kapitulli Politik: Mireqeverisja dhe Administrata Publike

Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Raporti i performancës për konsultimet publike, raportet vjetore të ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit, Regjistri Elektronik i Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike, faqet e internetit të ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit
Institucionet përgjegjëse për grumbullimin e të dhënave.	Departamenti për Zhvillim dhe Mireqeverisje, Kryeministria,
	ML
Përshkrimi i Metodologjisë	1) Numri i akteve të cilat kalojnë procesin e konsultimit publik kundërshtuar numrit të akteve të miratuara objekt i ligjit 2) Cilesia e procesit të konsultimit publik e cila bazohet në kriteret të vendosura në Ligjin Nr. 146/2014 "Për informimin dhe konsultimin publik"
Frekuenca e Matjes	vjetore
	vjetore
Natyra e Indikatorit/treguesit:	Rrites
Input	I përbërë

Formula e llogaritjes	1) Numri i akteve qe i nenshtrohen konsultimit publik perkundejt numrit te akteve te miratuara objekt i konsultimit publik. 2) Rezultati mesatar i vleresimit te cilësisë së procesit të konsultimit (sipas shkallëve të vlerësimit të dhëna ne metodologji) Metodologjia ndjek qasjen e SIGMA-s në matjen e cilësisë së konsultimeve publike, dhe bazohet në mbledhjen e të dhënave bazuar në raportet e ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit për konsultimet e kryera publike, si dhe të dhënat e mbledhura përmes RENJKP dhe faqeve të internetit të ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit.
Ndarja e të dhënave (per treguesit e perbere)	1) Numri i akteve qe i nenshtrohen konsultimit publik perkundejt numrit te akteve te miratuara objekt i konsultimit publik.
	2) Rezultati mesatar i vleresimit të cilësisë së procesit të konsultimit (sipas shkallëve të vlerësimit të dhëna ne metodologji)
	n/a
Theksoni drejtimin e ndryshimit / trendit (tendences) të ecurisë	Rrites

Vlerat Bazë	2015	
	n/a	
	2016	87%
	2017	87%
	2018	47.22%
	2019	71.42%
Vlera e synuar/ Targeti	2020	79.56%
	2020	5.66 pike
	2021	72,22%
	2021	4.94
	2021	trend rrites
Vlera e synuar/Targeti i rishikuar:	2022	trend rrites
SDG - Titulli i Qellimit të Zhvillimit të Qëndrueshëm sipas OKB-së	N/a	N/a
Vlera e Synuar e treguesit te SDG	N/a	N/a



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

Shtojcë II – Shembull/model pozitiv për raportin e konsultimeve bazuar në rezultate

Raport për rezultatet e konsultimit publik

RAPORT INDIVIDUAL PËR KONSULTIMIT PUBLIK
PËR PROJEKTAKTIN

Projektvendim “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 - 2030”
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

1. Titulli i Projektaktit:

Projektvendim “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 - 2030”

2. Kohëzgjatja e konsultimeve:

13 Nëntor 2020 – 20 Maj 2021²

3. Metoda e konsultimit:

- a) Takime³ me grupet e interesit⁴;
- b) Mbledhja e mendimeve dhe sugjerimeve, të dërguara nëpërmjet postës elektronike nga të interesuarat/interesuarit, në postën elektronike zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale⁵

- ² Datat e takimeve të zhvilluara në këtë periudhë kohore janë përkatësisht: 1) **Takim parapërgatitor** me NBJG qendrorë e vendor në datën **13 nëntor 2020** mbi rekomandimet nga vlerësimi i strategjisë së mëparshme dhe diskutimi mbi qëllimet kryesore strategjike; 2) **Takim parapërgatitor** me institucionet e pavarura, organizatat e shoqërisë civile dhe akademinë në datën **18 nëntor 2020**, mbi rekomandimet nga vlerësimi i strategjisë së mëparshme dhe diskutimi mbi qëllimet kryesore strategjike; 3) **Takim konsultues** me GNP mbi përzgjedhjen e qëllimeve strategjike dhe objektivat specifike të strategjisë së re, datë **18 dhjetor 2020**; 4) **Takim konsultues** me GNP mbi konfirmimin e qëllimeve strategjike dhe objektiveve specifike të formuluar bazuar në komentet e marra, datë **2 shkurt 2021**; 5) **Takim konsultues** me GNP dhe NBJG qendrorë e vendorë mbi logjikën e ndërhyrjes (qëllime strategjike, objektiva specifike dhe masa të propozuara), datë **4 mars 2021**; 6) **Takim konsultues** me institucionet e pavarura dhe organizatat e shoqërisë civile mbi logjikën e ndërhyrjes (qëllime strategjike, objektiva specifike dhe masa të propozuara), datë **5 mars 2021**. Takim konsultues me Aleancën Kombëtare të Këshilltareve, datë **09.04.2021**;

³Për shkak të respektimit të masave lidhur me situatën e COVID-19, takimet janë zhvilluar **online**.

⁴ Grupet e interesit nënkupton: institucionet shtetërore dhe jo-shtetërore në nivel qendror dhe të vetëqeverisjes vendore, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, institucionet e pavarura, akademinë dhe organizatat e shoqërisë civile të specializuara për trajtimin e çështjeve të barazisë gjinore, dhunë me bazë gjinore e dhunës në familje.

- c) Takim konsultues me Grupin Tematik Ndërinstitucional të Përfshirjes dhe Mbrojtjes Sociale, datë 15.04.2021
- d) Mbledhja e Këshillit Konsultativ Qeveri Qendrore – Vetëqeverisje Vendore, datë 20.05.2021
- e) Draft-SKBJGJ është publikuar për konsultim publik në datën 23 mars 2021 në adresën: <https://ëëë.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/347>

4. Palët e interesit të përfshira:

Ministritë e linjës⁶, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore⁷ (Nëpunëset/nëpunësit e Barazisë Gjinore dhe Koordinatorët/koordinatorët Vendorë kundër Dhunës në Familje), Policia e Shtetit Shqiptar, INSTAT, Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, organizatat e shoqërisë civile⁸. Gjithashtu janë përfshirë rregullisht në takimet parapërgatitore dhe ato konsultuese edhe përfaqësues dhe përfaqësues nga Departamenti për Zhvillim dhe Mirëqeverisje pranë Kryeministritë.

Gjithsej **të angazhuar aktivisht** me dhënie komentesh në takimet parapërgatitore dhe ato konsultuese, si dhe me shkrim, rezultojnë **37 institucione**⁹ qendrore dhe vendore, institucione të pavarura dhe organizata të shoqërisë civile.

Të pranishëm në takimet parapërgatitore dhe konsultuese ishin **75 institucione**¹⁰ qendrore dhe vendore, institucione të pavarura dhe organizata të shoqërisë civile.

Të ftuar në takimet parapërgatitore dhe konsultuese ishin **151 institucione**¹¹ qendrore dhe vendore, institucione të pavarura dhe organizata të shoqërisë civile.

Të angazhuara në mbështetje të gjithë punës së GNP-së ishin **4 eksperte**¹² për çështjet e barazisë gjinore, dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, statistikave gjinore e treguesve gjinorë, kostimit dhe buxhetimit të përgjigjshëm gjinor, të cilat u mundësuan përmes mbështetjes së UN Women.

⁵Këto mendime janë përcjellë pas takimeve online, si dhe në periudha ndërmjet përmirësimit të drafteve të dokumentit nga ana e Grupit Ndërinstitucional të Punës. Korrespondenca është mbajtur nëpërmjet adresave zyrtare të stafit të Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (kryesisht nëpërmjet adresave të Sektorit të Politikave dhe Strategjive të Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore).

⁶Veçojmë si aktive: Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (për pjesën e punësimit), Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrin e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes.

⁷Veçojmë si aktive bashkitë Klos, Kukës, Pogradec, Tiranë.

⁸Veçojmë si më aktive: AWEN, Qendra “Vatra” Vlorë, “Të Ndryshëm dhe të Barabartë” Tiranë (D&E), Qendra për Nisma Ligjore Qytetare Tiranë (CLCI), Qendra e Këshillimit për Gra dhe Vajza (QKGV) dhe Qendra e Këshillimit për Djem dhe Burra Tiranë (QKDB), Zyra për Djem dhe Burra Shkodër (ZBD), Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin Tiranë (ACPD), Qendra “Të drejtat e njeriut në demokraci” Tiranë (HRDC), Shoqata për Gratë, Paqen dhe Sigurinë Durrës, Qendra për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen” Tiranë, Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”(QAGJZH), Strehëza për Gratë dhe Vajzat Tiranë, Shoqata Kombëtare e Punonjësve Socialë, Forumi i Gruas Elbasan (FGE), Qendra Mary Ward Loreto Shqipëri, Qendra për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri (CRCA), Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (ADRF).

⁹ 10 ministritë anëtare të GNP-së, INSTAT, AP, KMD, PSHSH, 4 NJVV-të përkatësisht Klos, Kukës, Pogradec dhe Tiranë, 18 organizata të shoqërisë civile, si dhe Departamenti për Zhvillim dhe Mirëqeverisje pranë Kryeministritë.

¹⁰ 15 ministritë anëtare të GNP-së, INSTAT, AP, KMD, PSHSH, 35 NJVV, 30 organizata të shoqërisë civile, si dhe Departamenti për Zhvillim dhe Mirëqeverisje pranë Kryeministritë.

¹¹ 15 ministritë anëtare të GNP-së, INSTAT, AP, KMD, PSHSH, 61 NJVV, 70 organizata të shoqërisë civile, si dhe Departamenti për Zhvillim dhe Mirëqeverisje pranë Kryeministritë.

¹²Monika Kocaqi, Rajmonda Duka, Ani Plaku, Blerina Xhani

Grupi Ndërinstitucional i Punës për hartimin e SKBGJ 2021 – 2030 i ngritur me Urdhër të Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 592 datë 20.10.2020 “Për ngritjen e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Hartimin e Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore dhe planit të veprimit 2021 – 2030”, përbëhej nga **15 institucione** dhe gjithsej 20 anëtare/anëtarë¹³.

¹³ Konkretisht: MSHMS me Kryetarin dhe 5 anëtare, si dhe institucionet e tjera me nga një anëtar/anëtare, si: Ministria e Drejtësisë, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Kulturës, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministri i Shtetit për Diasporën, Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, INSTAT, Policia e Shtetit Shqiptar.

Çështja e adresuar	Komenti	Palët e interesuara	Vendimi	Justifikimi
Të drejtat pronësore të grave dhe vajzave	Informimi i grave dhe vajzave të bëhet mbi të drejtat në përgjithësi dhe jo vetëm mbi të drejtat e tyre në lidhje me pronësinë mbi tokën bujqësore. INSTAT nuk kryen studime mbi të drejtat pronësore të grave mbi tokën bujqësore	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi INSTAT	<i>I pranuar.</i> Reflektuar në objektivin specifik I.2, konkretisht në masën I.2.1. <i>I pranuar.</i> U bë ndryshimi i institucionit përgjegjës dhe i kaloi kjo përgjegjësi MBZHR-së	Nuk ka. Nuk ka.
Diskriminimi gjinor dhe diskriminimi i shumëfishtë në vendin e punës.	Në kurset e formimit profesional të parashikuara të shtohen edhe module me informacion kundër diskriminimit gjinor, që të parapërgatiten gratë dhe vajzat për hyrjen në tregun e punës. Të parashikohet shërbim ligjor dhe psikologjik falas për gra dhe vajza që denoncojnë diskriminim gjinor në vendin e punës.	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Qendra “Vatra”	<i>I pranuar.</i> Reflektuar në objektivin specifik I.3, konkretisht në masën I.3.1 (aktivitetet I.3.1.c dhe I.3.1.e) <i>I pranuar pjesërisht.</i> Ka masa të parashikuara për këtë qëllim në objektivat specifike III.2 (konkretisht nën masën III.2.4) dhe nën objektivin specifik III.3 (konkretisht nën masën III.3.1.)	Nuk ka. Parashikimet nën objektivat specifike III.2 dhe III.3 plotësohen edhe nga parashikimet nën Objektivin specifik I.3, konkretisht nën masën I.3.2 dedikuar zbatimit të Konventës C190- të ONP.
Ndarje e barabartë	Në inkurajimin e	Ministria e	<i>I pranuar.</i>	Nuk ka.

ndërmjet grave dhe burrave, e punës së papaguar të kujdesit familjar.	baballarëve për aplikimin dhe marrjen e lejeve të paguara për një angazhim më të madh të tyre në punët e papaguara në familje, të adresohet edhe nevoja për ndryshime ligjore bazuar në praktikën e mirë ndërkombëtare. Sondazhi për numrin e punëmarrëseve /punëmarrësve që kanë aplikuar dhe marrë leje të paguara sipas legjislacionit nuk mund të kryhet ngas INSTAT	Brendshme NJVV Pogradec INSTAT	Reflektuar në objektivin specifik I.1, konkretisht në të gjitha aktivitetet e parashikuara nën masën I.1.2. <i>I pranuar.</i> U ndryshua nga INSTAT në MFE	Nuk ka.
Zvogëlimi i barrierave që mbajnë gratë dhe vajzat larg tregut të punës.	Ngritja e çerdheve/kopshteve pranë qendrave të punës nga punëdhënësit, të mos aplikohet vetëm për biznesin privat por edhe për administratën shtetërore.	Ministria e Brendshme	<i>I pranuar pjesërisht.</i> Në objektivin specifik I.3, nën masën I.3.1. është parashikuar një aktivitet për këtë qëllim i formuluar në mënyrë të përgjithshme, pra pa e cituar biznesin privat si targetin kryesor.	Në vitet e para të zbatimit të SKBGJ 2021 – 2030 ky aktivitet do të pilotohet si bashkëpunim me sektorin privat. Më pas nëse rezultojnë suksesshëm mund të shtrihet si shërbim edhe në administratën shtetërore.
Investimi në prindërimin pozitiv.	Ngritja e qendrave të këshillimit paramartesor të shoqërohet dhe me	Ministria e Brendshme	<i>I pranuar pjesërisht.</i> Kostimi është kryer	Saktësimi i institucionit përgjegjës nëse do jetë MB

	kostimin përkatës dhe të saktësohet institucioni kryesor përgjegjës nëse do jetë në nivel qendror apo vendor.		për të gjitha veprimet e parashikuara në planin e veprimit për zbatimin e SKBGJ 2021 – 2030.	(DPGJC në nivel qendror) apo në nivel të NJVV-ve, i mbetet vetë MB për ta vendosur.
Mbulimi më i mirë me shërbime sociale përmes financimit nga Fondi Social	Shtimi i këtyre shërbimeve sociale mund të vijë edhe nëpërmjet inkurajimit të bashkëpunimit me OSHC e specializuara në këtë drejtim	Rrjeti i Fuqizimit të Gruas Shqipëri (AËEN)	<i>I pranuar pjesërisht.</i> Reflektuar nën objektivin specifik I.3. konkretisht nën masën I.3.4.	Sugjerimi ka zënë vend jo për parashikimet nën Fondin Social por, për financimin për ndërmarrjet sociale, që i dedikohet pikërisht bashkëpunimit me OSHC e specializuara.
Studimi i tregut dhe planifikimi i kurseve të formimit profesional	Shtimi i kurseve të formimit profesional dhe llojshmërisë së tyre, të ofruar nga qendrat përkatëse të paraprihet nga studimi i kërkesave të tregut të punës Të shtohet si tregues edhe numri i bizneseve të monitoruara ku gratë punësohen nëpërmjet zyrave të punës	Rrjeti i Fuqizimit të Gruas Shqipëri (AËEN) Qendra “Vatra” Qendra “Vatra”	<i>I pranuar.</i> Reflektuar në objektivin specifik I.3, konkretisht nën masën I.3.1, aktiviteti I.3.1.a. <i>I pranuar pjesërisht.</i> Nën objektivin specifik I.3. u rishikua formulimi i treguesit I.3.a i cili do të masë përqindjen e punëkërkuarëve të papuna, të punësuar nëpërmjet ndërmjetësimeve të zyrave të punësimit	Nuk ka. Treguesit janë formuluar në atë mënyrë që të mund të jenë të matshëm dhe me bazë krahasuese. Formulimi i këtij treguesi është propozuar nga vetë MFE.

			ndaj totalit të punëkërkesve të papunë të punësuar nga këto zyra punësimi, në shkallë vendi	
Informimi i vajzave dhe djemve mbi shëndetin seksual e riprodhues	Në modulën mbi trupin e njeriut dhe seksualitetin, të përfshirë në kurrikulat e arsimit nëntë-vjeçar, të shtohet edhe moduli mbi marrdhëniet e shëndetshme intime dhe legjislacionin mbi dhunën në këtë drejtim Informimi i nxënësve mbi seksualitetin të përfshihet në kurrikulën shkollë	Rrjeti i Fuqizimit të Gruas Shqipëri (AËEN) Qendra “Vatra”	<i>I pranuar pjesërisht.</i> Reflektuar në objektivin specifik III.5, nën masën III.5.2 dhe sidomos tek aktivitetet III.5.2.e dhe III.5.2.f. <i>I pranuar.</i> Nën objektivin specifik III.5, janë parashikuar aktivitete specifike për këtë qëllim nën masën III.5.2.	U konsiderua më e drejtë të shtohet një modul më vehte për diskutimin mbi praktikat e dëmshme dhe martesën e hershme e të detyruar të fëmijëve. Nuk ka.
Diskriminimi, seksizmi dhe dhuna ndaj grave në politikë	Të bëhet monitorim i komunikimeve publike të forcave politike dhe mediave audiovizuale lidhur me gjuhën dhe qasjen seksiste që synon të nëpërkëmbë dinjitetin e grave në politikë, duke përbërë diskriminim për shkak të gjinisë, si dhe të aplikohet sanksionim i shkeljeve konform legjislacionit	Rrjeti i Fuqizimit të Gruas Shqipëri (AËEN)	<i>I pranuar.</i> Nën objektivin specifik II.1, janë shtuar si masa të reja përkatësisht II.1.2, II.1.3, II.1.4 dhe II.1.5 që shkojnë në linjë (dhe madje më përtej) me komentën e dhënë	Nuk ka.

	përkatës kombëtar. Të përfshihet nga MASR edhe një modul me informacion mbi misogynjinë, seksizmin dhe diskriminimin gjinor në përgjithësi.	Rrjeti i Fuqizimit të Gruas Shqipëri (AËEN)	<i>I refuzuar.</i>	Riformulimi dhe shtimi i një tërësie masash e veprimesh, si nën objektivin specifik II.1 ashtu edhe nën qëllimin strategjik III, objektivin specifik III.4 dhe III.5, e adresojnë këtë koment.
Strehimi emergjent i rasteve të dhunës në familje	Të theksohet që strehëzat emërgjente të jenë funksionale dhe me të gjitha kushtet e nevojshme për një grua dhe fëmijët	Rrjeti i Fuqizimit të Gruas Shqipëri (AËEN)	<i>I refuzuar.</i>	Në objektivin specifik III.2, nën masën II.2.2., aktiviteti III.2.2.a theksohet qartësisht përmirësimi i kushteve, infrastrukturës, burimeve të këtyre strehëzave me qëllim funksionimin në përputhje me standardet e miratuara. Kjo e nënkupton pasjen e të gjitha kushteve për një nënë me fëmijë, sepse është e parashikuar në këto standarde. Pra nuk ka nevojë të

				ritheksohet më tej kjo gjë.
Rritja e masës së mbështetjes së viktimave të dhunës në familje të pajisuar me UMM/UM	Të parashikohet rritja e masës së mbështetjes ekonomike që u ofrohet viktimave të dhunës në familje të pajisura me UMM/UM dhe procedurat përkatëse për dhënien e kësaj ndihme sa më shpejt në kohë.	NJVV (bashkitë Klos dhe Kukës) Rrjeti i Fuqizimit të Gruas Shqipëri (AËEN)	<i>I refuzuar</i>	Në masat e ndërmarra nga QSH në kuadër të rimëkëmbjes nga pandemia e COVID-19 është bërë tashmë dyfishimi i të gjitha pagesave që vijnë në formën e ndihmës ekonomike, që nga fillimi i vitit 2021.
Fuqizimi i mekanizmit kombëtar të barazisë gjinore	Planifikimi për fuqizimin e strukturës përkatëse përgjegjëse shtetërore për barazinë gjinore, të jetë sa më i qartë	Rrjeti i Fuqizimit të Gruas Shqipëri (AËEN) Avokati i Popullit	<i>I pranuar.</i> Parashikuar në mënyrë më të detajuar nën objektivin specifik IV.1, nën masën IV.1.2.	Nuk ka.
Formulimi i vizionit	Të përmendet në formulimin e vizionit edhe riintegrimi i viktimave të dhunës në familje, krahas mbrojtjes dhe trajtimit të tyre	Qendra “Vatra” Vlorë	<i>I pranuar.</i> U pasqyrua në formulimin e vizionit	Nuk ka.
Shërbimi ligjor falas dhe treguesit lidhur me shërbimin ligjor falas.	Të detajohen treguesit në lidhje me ofrimin e shërbimit ligjor falas nga Klinikat Ligjore, OJF-të dhe Qendrat e Ndihmës Ligjore Falas.	Qendra “Vatra” Vlorë	<i>I pranuar pjesërisht.</i> Detajimi i treguesve është bërë në një masë të caktuar duke pasur parasysh edhe formulimin e tyre si tregues impakti, rezultati apo mase.	Në objektivin specifik III.3. nën masën III.3.1., është parashikuar një aktivitet që përmbledh kërkesat për detajimin e treguesve siç sugjerohej, ku kërkohet

	Të evidentohet më vehte mbështetja që duhet t'u jepet OJF-ve dhe klinikave ligjore që ofrojnë shërbime ligjore falas Tek treguesit lidhur me trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore të bëhet ndarja ndërmjet numrit të rasteve të denoncuar dhe atyre të trajtuara	Qendra “Vatra” Vlorë CLCI Tiranë Qendra “Vatra” Vlorë	<i>I pranuar</i> Reflektar në aktivitetin III.3.1.b. <i>I pranuar.</i> Reflektuar në treguesin III.2.d. “Përqindja e rasteve të referuara të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës seksuale ndaj grave e vajzave, të cilat janë hetuar dhe dënuar.”	pikërisht mbledhja e të dhënave periodike mbi çështjet e trajtuara në QNLF, OJF e miratuara dhe klinikat ligjore, të disagreguara sipas seksit, moshës dhe karakteristikave të tjera. Nuk ka.
Fuqizimi ekonomik i grave dhe vajzave	Të mbështetet fillimi i sipërmarrjeve ekonomike të grave dhe vajzave nëpërmjet uljes/heqjes së tarifave fillestare për dy vitet e para. Gjithashtu të ofrohen edhe lehtësira fiskale për to. Të mbështeten sidomos gratë dhe vajzat e zonave rurale, veçanërisht në përdorimin e	Shoqata “Gruaja, Paqja, Siguria”, Durrës Mary Ēard Loreto Organizata “D&E” Avokati i Popullit	<i>I pranuar.</i> Reflektuar në objektivin specifik I.2, masa I.2.2., aktivitetet I.2.2.f dhe I.2.2.g. <i>I pranuar.</i> Përfshirë tek objektivi specifik I.2, masa I.2.2., aktiviteti I.2.2.h.	Nuk ka. Nuk ka.

	risive teknologjike			
Zbatimi me efektivitet i legjislacionit	Në rast të mosangazhimit të anëtarëve të MKR-ve të aplikohet ndëshkimi konform kuadrit ligjor ekzistues	CLCI Tiranë Forumi i Gruas Elbasan	<i>I pranuar.</i> Përfshirë tek objektivi specifik III.1, masa III.1.2., aktiviteti III.1.2.f.	Nuk ka.
Shërbimet mbështetëse të specializuara	Të shtohet mbështetja e shërbimeve të këshillimit psikologjik Të ofrohen shërbime për viktimat të cilat vuajnë nga probleme të shëndetit mendor	Shoqata “Gruaja, Paqja, Siguria”, Durrës NJVV Kukës	<i>I pranuar.</i> Përfshirë tek objektivi specifik III.2, masa III.2.4., aktiviteti III.2.4.a. <i>I pranuar.</i> Përfshirë tek objektivi specifik III.2, masa III.2.1., aktiviteti III.2.1.a.	Nuk ka. Nuk ka.
Fuqizimi ekonomik të grave dhe vajzave,	1.1.Akses më i mirë i vajzave të reja në "profesionet e së ardhmes". 1.2.Ngritja e qendrave të këshillimit të karrierës veçanërisht për profesione të reja që lidhen me tregun e ardhshëm të punës (ekonomia e gjelbër, ekonomia digjitale etj.) ku duam të	Aleanca Keshiltaree grave	Pranuar ne masen me te madhe Sugjerimi 1.1. realizohet nëpërmjet veprimeve të parashikuara tek I.3.1; Sugjerimi 1.2 realizohet brenda I.3.1.c Sugjerimi 1.3. realizohet nëpërmjet 1.3.1.a, Sugjerimi 1.4 realizohet nëpërmjet I.2.2.f., I.2.2.h., I.2.4.a; Sugjerimi 1.5. realizohet nëpërmjet I.2.2.k.,	

	nxisim aksesin e grave dhe vajzave (dhe ku është parë një deficit në edukimin e vazhduar të vajzave) në nivel vendor (bazuar në modelet e përparuara në disa bashki), duke filluar më bashkitë më të mëdha në 5 vitet e ardhshme, e duke vijuar më tej me bashkitë e tjera. 1.3.Zhvillimi i kërkimeve akademike për të analizuar se cilat janë pengesat për pjesëmarrjen dhe arritjet e vajzave në STEM për identifikimin e praktikave të mira se çfarë funksionon në programet STEM dhe për të hartuar mundësitë e ardhshme. 1.4.Fuqizimi ekonomik (i		si dhe matet nga treguesit I.2.c dhe I.2.d; Sugjerimi 1.6 realizohet nëpërmjet I.2.2.g, ku kërkohet heqja e tarifave fillestare për 2 vjet, gjithsesi u shtua edhe heqja e tarifës për ujin e vaditjes, heqja e tarifës për drutë e zjarrit, për gratë rurale; Për sugjerimin 1.7 është parashikuar tek I.3.1.g. ngritja e shërbimit parashkollor si pilotim me 5 biznese. Kthimi i kësaj ideje në iniciativë ligjore mund të bëhet në fazen e dytë (pra pas rishikimit të SKBGJ në 2025), duke u bazuar edhe tek rezultatet e arritura nga ky pilotim. Për këtë u shtua një fjali në formulimin e I.3.1.g; Për sugjerimin 1.8 u shtua një aktivitet – shiko I.2.2.l Sugjerimi 2.1 i parashikuar tek I.2.2.c.; Sugjerimi 2.2. i parashikuar tek I.2.2.h. Rekomandimet 3.1 dhe 3.2 u përfshinë pjesërisht tek	
--	---	--	---	--

	përqendruar tek gratë rurale). 1.5.Vendosja e kriterëve (dhe monitorimimi i tyre), lidhur me përmirësimin e aksesit të grave të zonave rurale në financimet nga qeveria/donat orët. 1.6.Promovimi i praktikave të mira për mbështetjen e grave në zonat rurale, të tilla si: heqja e tarifës për ujin e vaditjes, heqja e tarifës për drutë e zjarrit, etj, të cilat janë realizuar nga Aleanca e Grave Këshilltare dhe kanë rezultuar me impakt pozitiv në disa nga bashkitë e vendit. 1.7.Iniciativë ligjore: Ndërmarrjet publike apo private më një		takimet e parashikuara tek I.3.1.e; Për rekomandimin 3.3. u përmiresua formulimi i I.3.1.e; Rekomandimet 3.4. dhe 3.5 nuk lidhen me QS 1. Rekomandimi 4.1 dhe 4.2 reflektuar tek II.1.4; Për rekomandimin 4.3 nuk mund të bëjmë ndryshime sepse vetë Ministria e Brendshme në komentet e saj nuk na ka kërkuar ndryshime në lidhje me këtë pikë; Për rekomandimin 4.4 është shtuar promovimi i modeleve pozitive tek II.1.1.a dhe II.1.1.b dhe II.1.2.b; Për rekomandimin 4.5 është shtuar në formulimin e II.1.2.b pjesa e aktiviteteve gjatë ditëve të caktuara për barazinë gjinore, por jo e konceptuar si një javë e plotë; Përsa i takon 4.6 mendojmë se gjen vend në të gjitha aktivitetet e parashikuara me të dy gjinitë nën masat e QS II, si dhe në	
--	--	--	--	--

	numër të caktuar punonjësesh me fëmijë, të hapin kopshte pranë qendrave të punës, ndërsa pushteti vendor të ofrojë edukatore (hartimi i kuadrit ligjor mundësues bazuar në parimet e përgjegjësisë sociale të koorportave). 1.8.Krijimi i një rrjeti të grave të suksesshme në biznes (pjesë e Diasporës Shqiptare) dhe mundësimi i krijimit të urave lidhëse (iniciativa binjakëzimi) me komunitetin e grave sipërmarrëse në Shqipëri.		parashikimin për futjen në kurrikulën e FSHS edhe e modulit për djemtë dhe burrat (shiko II.4.1.e). Për 5.1, shërbimet mbështetëse të specializuara janë parashikuar të monitorohen çdo tre vjet nga MSHMS në bashkëpunim me NJVV (shiko III.2.4.c), si dhe tek I.3.3.e për shërbimet në nivel NJVV që mbulohen nga fondi social; Rekomandimi 5.2 i parashikuar tek III.1.2.e; Rekomandimi 5.3 adresohet nëpërmjet parashikimit të strehimit emergjent si shërbim në nivel NJVV (shiko III.2.2.) si dhe nëpërmjet detyrimeve për mirëfunksionimin e MKR-ve (shiko III.2.5.a); Rekomandimi 5.4 i adresuar tek III.2.5.b; Rekomandimi 5.5 mund të parashikohet si i tillë në periudhën e rishikimit të SKBGJ në vitin 2025;	
--	---	--	---	--

			Rekomandimi 5.6 adresuar tek III.2.4 dhe tek III.1.3.a. Rekomandimi më sipër u reflektua nëpërmjet pikave si në vijim: Rekomandimi 6.1 zbatohet në momentin që hartohen planet vendore të veprimit për BGJ siç janë parashikuar nën IV.3.1; Rekomandimi 6.2. adresuar tek III.2.5.a. dhe IV.1.2.d; Rekomandimet 6.3 – 6.7. adresuar pjesërisht tek IV.3.1, të cilat mund të adresohen më pas plotësisht gjatë hartimit të planeve vendore për BGJ	
--	--	--	---	--

5. Pasqyra e komenteve të pranuara me arsyetimin e komenteve të pranuara/refuzuara.